




Breaking News:

Korçë – Finalizohet operacioni policor i koduar “Hidden gun”



16/03/2023

Krujë – Finalizohet Operacioni Policor I Koduar “Rakordimi”

Krujë/Finalizohet operacioni policor i koduar “Rakordimi”, për lokalizimin dhe kapjen e një shtetasi të shpallur në kërkim.

Qëlloi me armë zjarri, në drejtim të një banese në Shkodër, në janar të vitit 2022, për shkak të një konflikti për motive pronësie, lokalizohet, kapet dhe vihet në pranga 49-vjeçari.

Shërbimet e Komisarariatit të Policisë Krujë, me mbështetjen e inteligjencës informative dhe si rezultat i shkëmbimit të informacionit me Policinë e Shkodrës, me qëllim lokalizimin dhe kapjen e një shtetasi të shpallur në kërkim për armëmbajtje pa leje, kanë organizuar dhe finalizuar operacionin policor të koduar “Rakordimi”.

Në kuadër të këtij operacioni, u kap dhe u vu në pranga shtetasi i kërkuar D. A., 49 vjeç, banues në fshatin Dukagjinin e Ri, Krujë, pasi Gjykata e Rrethit Gjyqësor Shkodër i ka caktuar masën e sigurisë “Arrest në burg”, për veprat penale “Mbajtja pa leje dhe prodhimi i armëve, armëve shpërthyesë dhe i municionit” dhe “Prishja e qetësisë publike”.

Shtetasi D. A., më datë 26.01.2022, në fshatin Kasnec, Shkodër, për shkak të një konflikti për motive pronësie, ka qëlluar me armë zjarri, në drejtim të banesës së shtetasit N. U.

49-vjeçari iu dorëzua Drejtorisë Vendore të Policisë Shkodër, për kryerjen e veprimeve të mëtejshme procedurale.

◀ Elbasan – Finalizohet operacioni policor i koduar “Vetëgjyqësia”

Fier – Vihet në pranga 1 shtetas ▶

Kërko

Enter a word for search

Komisariati Dixhital

GET IT ON
Google Play

Download on the
App Store

Arkiva

Select Month

Linqe

>

Arkiva

>

Akademia e Sigurisë

>

Ministria e Brendshme

>

Agjencia e Mbikëqyrjes Policore

>

Interpol

>

Europol

>

Misioni PAMECA V

>

SCPA

>

Projekti Trivalent